

KËRKIME GJUHËSORE

Naim BERISHA

EMËRTIMI I KAFSHËVE NË GJAKOVË ME RRETHINË

Rrafshi i Dukagjinit njihet si një hapësirë e përshtatshme për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë. Terreni me kullota të shumta, klima e përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë blegtorale, tradita e vazhduar nëpër breza etj., janë elemente që tregojnë se në këto hapësira kishte kushte të mira për zhvillimin e këtyre veprimtarive. Gjakova me rrethinë, si pjesë e kësaj hapësire gjeografike, një ndër veprimtaritë më të rëndësishme në zhvillimin e jetës kishte blegtorinë.

Zhvillimi i jetesës në kushte të këtilla vetvetiu ka ndikuar në krijimin e një numri të madh emërtimeve për kafshët në përgjithësi. Veprimtaria blegtorale në këtë hapësirë gjeografike, në njëfarë mënyre identifikohet me lopët dhe dhentë, sepse kafshët tjera ishin dhe janë më të pakta në krahasim me to. Kjo, vetvetiu nënkupton se bariu dhe intelijenca popullore kryesisht janë fokusuar në emërtimet e lopëve dhe te dhenve duke marrë për bazë elemente të ndryshme për emërtimin e tyre.

Një pjesë e rëndësishme e kësaj pasurie gjuhësore janë edhe njësitë frazeologjike që janë formuar duke u motivuar nga kafshët, me anën e të cilave është pasqyruar mjaft mirë jeta shpirtërore dhe materiale e kësaj ane.

Ashtu si në mbarë leksikun e shqipës, emërtimet mbi kafshët gjithmonë kanë pasur për bazë elemente nga të cilat janë motivuar. Pra, kemi fjalë apo emërtime të formuara mbi bazën e *vetive fizike* të ndonjë pjese të trupit, mbi bazën e *ngjyrës*, mbi bazën e *vendit* nga vjen apo nga mendohet se ka ardhur, emërtime që janë motivuar **mbi një shenjë në ballë**, emërtimet mbi **formën e brirëve** etj.

Të motivuara nga ndonjë pjese e trupit gjejmë fjalë si: *çafgati/-a*, - lopa apo mëzati që e ka qafën e gjatë, pastaj kemi **krru:ta** – për lopën që e ka formën e trupit të kthyer; **bullica** – për lopën apo delen që është e trashë në trup, pra kemi emërtim të formuar mbi bazën e krahasimit me buallicën; **skele** – emërtim për lopën e cila rri pothuajse gjithmonë e dobët nga shëndeti etj.

Për bariun, ngjyra ka shërbyer si element shumë i rëndësishëm në krijimin e emërtimeve të ndryshme. Mbi bazën e *ngjyrës* kemi: *kuqësh* - emër lope i vënë duke marrë për bazë ngjyrën e kuqe; *kuqoj* – emër mëzati me ngjyrë të kuqe; *murricë* – emër lope me ngjyrë të murrme; *bardhokë* – emër deleje me ngjyrë të bardhë; *bardhec* – emër kali me ngjyrë të bardhë; *bardhosh* – emër qeni me ngjyrë të bardhë. Emërtime tjera të motivuara nga ngjyra janë: *galë*, *galicë*, *galan*, *bardhokêjk*, *bardhokan*, *murrin*, *kryezéz* etj.

Duke pasur për bazë ngjyrën, janë formuar edhe një numër emërtimeve të motivuara nga ndërthurja e ngjyrave dhe shenjat në ballë e në trup, si: *balushë*; *balushan*, *balushêjk*, *larë*, *larok*, *larojk*, etj, për lopët dhe delet; *sharan*, *vrizhë*, *vrizhan*, *balushan*, *samurr* etj, për qentë; *pullali*, *zekan*, *laran*, për kuajt etj.

Në leksikun e Gjakovës me rrethinë nuk gjejmë emërtime të veçanta për gomarin apo për mushkën. Një arsye mund të jetë numri i vogël i tyre. Emërtimi i

NAIM BERISHA

tyre zakonisht është bërë duke e identifikuar me emrin e pronarit, p.sh **magari i Ismetit**.

Mushka nuk bën pjesë në grupin e kafshëve të transportit që janë përdorur në Gjakovë me rrethinë, andaj mungojnë edhe emërtimet për të. Në disa raste të rralla kur është mbajtur mushka, emërtimi për të është bërë gjithashtu mbi emrin e pronarit, p.sh **mushka e Shabanit** etj.

Mbi bazën e vendit nga vjen apo mendohet se ka ardhur kemi emrin e racës së deleve **goréjk**, - **a**, dele e ardhur nga Gora; **Magari i Hasit** etj.

Një grup më vete përbëjnë edhe emërtimet të cilat janë motivuar nga forma e **brirëve**. Këto emërtime ndahen në dy grupe, emërtimet njëgjymtyrëshe dhe emërtimet dygjymtyrëshe.

Emërtime njëgjymtyrëshe të motivuara nga forma e brirëve janë: **krru:t**, - lopa që i ka brirët e kthyer (ky emërtim na del si homonim i emërtimit **krru:t** të motivuar nga vetitë fizike të kafshës të cilën e përmendëm më lartë), **krrulëjka** – lopë me brirë shumë të kthyer në formë të rrumbullakët, **shytë** - lopa me brirë të prerë ose raca e lopëve pa brirë; **gaxhele** – lopë me brirë të shtrembër dhe jo në mënyrë të njëjtë, (ky emërtim është motivuar duke u krahasuar nga forma jo e rregullt e brirëve me **gaxhelin**, – është strumbullar me degë afërsisht 50 cm, në të vendoset bari i kositur në vjeshtë që nuk është i tharë sa duhet dhe degët e tij e mundësojnë futjen e ajrit në brendi për ta ruajtur nga myku) etj.

Emërtimet dygjymtyrëshe të cilat e kanë për bazë formën e brirëve janë: bri:thymja, bri:krruta, bri:hapta, bri:shyta, bri:gata, bri:shkurta etj.

Bartja e emërtimeve të kësaj fushe me ngjyrim emocionuese tek njerëzit është interesante dhe e shpeshtë në këtë anë.

Emërtimet e formuara mbi bazën e ngjyrës i gjejmë me përdorime të ndryshme emocionuese dhe stilistike për njerëzit. Më i shpeshtë është përdorimi i tyre për t'i përqeshur njerëzit. **Kuqësh** i thuhet një vajze që i ka faqet e kuqe kur dikush e ngacmon. Pastaj kemi fjalën **kuqoj** - epitete negativ që u jepet djemve të cilët i kanë faqet e kuqe dhe që janë kokëfortë, nuk marrin vesh me fjalë. Me të njëjtin kuptim përdoren edhe fjalët **balúsh**, **balushejk**, **balushan** etj.

Me kuptim negativ dhe përqeshës përdoren edhe fjalët **krru:t/krrutan**, i thuhet dikujt që ka një deformim në trup, apo që nuk e ka por i vihet epitete për ta përqeshur.

Ka një numër fjalësh që përdoren me më shumë se një kuptim, shembull për këtë konstatim është fjala **krrutan**. Përveç kuptimit të parë që bazohet në formën fizike për ta përqeshur, **krrutan** i thuhet dikujt që është i vendosur në qëllimin e vet për kryerjen e ndonjë pune, njeri që nuk lëshon pe. *A krrutani qe asht ai bre, nuk lshon pê veç me e my:t!*

Emërtim i motivuar nga vendi nga i cili mendohet se ka ardhur dhe që përdoret me ngjyrim emocionues negativ është **Magari i Hasit**, kjo fjalë përdoret si epitete që i është dhënë dikujt, tregon kokëfortësinë, zotësinë fizike për të bartur peshat të rënda mbi supet, vendosmërinë për kryerjen e punëve etj, kuptime këto që në shumicën e rasteve kanë ngjyrim negativ dhe përqeshës.

EMËRTIMI I KAFSHËVE NË GJAKOVË ME RRETHINË

Bartja e kuptimit të këtyre emërtimeve tek njerëzit është një veti interesante e mbarë shqipes. Se kjo prirje është e mbarë shqipes, e vërteton edhe citimi që e kemi përzgjedhur nga prof. Valter Memisha në studimin “Rreth emërtimeve të kafshëve në Labëri”¹:

Por ndodh një çudi: emërtimet e kafshëve të buta përdoren me ngjyrim emocionues negativ (kur kafshët janë të dobishme), kurse emërtimet e kafshëve të egra përdoren me ngjyrim emocionues pozitiv, një dukuri etnolinguistike e etnokulturore për t’u studiuar më tej.

Emërtimet që lidhen me shpendët në përgjithësi nuk paraqesin veçanti të shumta dalluese me hapësirat tjera shqiptare. Emërtimet mbi shpendët të cilat mendojmë se paraqesin veçanti janë një numër i vogël fjalësh. Kemi emërtime të formuara mbi bazën e imitimit të zërave (onomatopeike) si: **guguisuf**, - lloj shpendi i ngjashëm me pëllumbin, zëri që lëshon ky shpend është i përafërt me fjalën *guguisuf*, nga e ka marrë edhe emrin.

Është tjetër interesant është emri dygjymtyrësh **sorrshki:n**, - me këtë emër në këtë anë njihet laraska. Fjalori elektronik shpjegues i përgatitur nga Qendra për Edukim dhe Përparim, e jep një shpjegim tjetër, “*Shpend i zi me gushë të bardhë, me zë të çjerrë, që i ngjan dallëndyshe*”. Në leksikon e kësaj ane, baza kuptimore e këtij emërtimi lidhet me dëmin e madh që shkakton ky shpend, dëm i cili krahasohet me dëmin e pushtuesit dhe armikut tonë “shkaut”. Shembull: *Nuk dojn me na la:n ni zog per fa:r kto sorrshkina*.

Emërtime tjera nga kjo fushë të cilat mund t’i veçojmë janë: **kajù:sh** – emërtim për lejlekun, **gri:z** – lloj shpendi i ngjashëm me laraskën por me shumë ngjyra, **sorrgahu:t** - sorrë e madhe me ngjyrë hiri dhe të zezë etj.

Duke jetuar në një hapësirë kryesisht blegtorale dhe duke e njohur mirë këtë veprimtari, banori i kësaj ane e krijoi edhe një pasuri të çmuar të njësive frazeologjike. Këto njësi frazeologjike janë pasqyra më reale e zhvillimit të jetesës në këto anë. Te krijuara për një periudhë të gjatë kohore, frazeologjitë e motivuara nga kafshët, pasqyrojnë kulturën shpirtërore e materiale të kësaj ane, si dhe zhvillimin e jetës në përgjithësi.

Njësitë frazeologjike që lidhen më kafshët: **Qeni i t’fortit** - argat i okupatorit, i shitur, këtë njësi e gjejmë të përdorur edhe në pjesë tjera të Rrafshit të Dukagjinit; po punon **si kali i Bardhecit** – i etur për punë, nuk ndalet (Bardheci është banor i fshatit Osek kali i të cilit kishte nam në atë anë); me kuptim përçmues përdoret thi: Novoselle – kokëtrashë dhe i padëgjueshëm, Novosella është fshat i banuar me besimtarë katolik të cilët shquhen për rritjen e derrave të mëdhenj që shpesh u bëjnë dëme të tjerëve në ara dhe livadhe; **e ka qit synin e qenit** – i ka dal turpi(marrja), nuk merr vesh për asgjë tjetër; **i lëshon fjalt si lopa baglen** – i lëshon pa menduar; **si lopa e Mejremit** – i humbur, njeri i lënë pasdore e pa përkujdesje (Mejremja është e vetme dhe të vetmen punë që bën është përkujdesja e lopëve, por, moshë e saj e shtyrë bën që lopët shpesh të humbin dhe

¹ Valter Memisha, *Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.

NAIM BERISHA

të shihen gjithandej); **ja hanger xheli kapsollin** – u dobësua, i humbi fuqia; **i shti:n brinat ner veti** - u zunë njëri me tjetrin etj.

Materiali të cilin e parashtruam më lartë, është një pjesë e vogël e pasurisë leksikore të Gjakovës me rrethinë e cila shquhet me shumë veçanti interesante. Duhet përmendur se Gjakova si shtrirje gjeografike është pjesë e Rrafshit të Dukagjinit, hapësirë në të cilën zhvillimi i jetës e ka njëfarë kompaktësie më vete. Kjo nënkupton se emërtimet dhe njësitë frazeologjike që i kemi mbledhur në Gjakovë me rrethinë shpeshherë i kanë kaluar kufijtë lokal dhe shtrirja e tyre gjeografike është më e gjerë.

BIBLIOGRAFI

- Abdul Sulo, *Visare gjuhësore – kulturore nga malësia e Gjakovës I, II*, Tiranë, 2000.
- Bajram Mehmetaj, *E folmja e Deçanit me rrethinë*, Prishtinë, 2006.
- Jani Thomai, *Leksiku dialektor e krahinor në shqipen e sotme*, Tiranë, 2001.
- Çështje të frazeologjisë së gjuhës shqipe*. Tiranë, 1981.
- Fjalor frazeologjik i gjuhës shqipe*. Tiranë, 1999.
- Simon Pepa, *Tradita bujqësore nëpërmjet thesarit gjuhësor I, II*, Shkodër 2002
- Valter Memisha, *Rreth shndërrimit të togfjalëshit të lirë në njësi frazeologjike*, Studime filologjike, nr. 3-4, Tiranë 2006.
- Studime për fjalën shqipe*, Tiranë, 2011.
- Zenun Gjocaj, *Struktura leksiko-semantike e stilistike e frazeologjisë shqipe*, Prishtinë 2001.
- Çështje të homonimisë e sinonimisë frazeologjike shqipe*, Prishtinë, 1998.